



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBRUESVE GJYQËSORË PRIVAT
ZYRA PËRMBARIMIT PRIVAT "ALBASE" SH.P.K.

Adresa : Rr. "Reshit Çollaku" pallati 24 kati i I

Tel. 0674005151

Nr.975/D

Tiranë, më dt.02.02.2022

Nr. 975/12 Prot.

Lënda : Urdhër për Heqjen e sekuestros konservative.

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Debitorit : Shoqërisë "Tosk Energji" shpk me NIPT L51817007A me Administrator Blerim Hoxha.

Adresa : Rr. "Papa Gjon Pali i II" qendra tregtare ABA, kati i 13, nr.1303, Tiranë.

Për dijëni : Ledia Llazar Plasa.

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Tiranë

Në Tiranë sot me dt.02.02.2022.

Unë Baftjar Abdulla Nela Përmbaues Gjyqësor Privat pranë Zyrës së Përmbaimit Privat "ALBASE" shpk, me çertifikatë Nr.66, dt.22.07.2011, lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, me NIPT L12009010A, bazuar në vendimin ekzekutimi i përkohshëm në origjinal Nr.5112, dt.02.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

K O N S T A T O V A :

Se në dt.10.12.2020 është depozituar kërkesa e kreditorës për ekzekutim pranë Zyrës së Përmbaimit Privat "ALBASE" shpk Tiranë së bashku me vendimin ekzekutimi i përkohshëm në origjinal Nr.5112, dt.02.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë:

-Kreditor : Ledia Llazar Plasa.

-Debitor : Shoqëria "Tosk Energji" shpk me NIPT L51817007A me Administrator Blerim Hoxha.

-Me objekt : Pranimin e kërkesës së kërkusit.

Detyrimin e pales së paditur Shoqëria "Tosk Energji" sha t'i paguajë paditëses Ledia Plasa si dëmshpërblim pagën e 12 (dymbëdhjetë) muajve punë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Tosk Energji" sha t'i paguajë paditëses Ledia Plasa si dëmshpërblim pagën e 2 (dy) muajve punë për shkak të mos respektimit të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Tosk Energji" sha t'i paguajë paditëses Ledia Plasa si dëmshpërblim pagën e 2 (dy) muajve punë për shkak të mos respektimit të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Tosk Energji" sha t'i paguajë paditëses Ledia Plasa pagën e muajit Nëntor dhe Dhjetor 2019 në masën e 500.000 lekë.

Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Tosk Energji" sha t'i paguajë paditëses Ledia Plasa diferencën e pagës së muajit Tetor 2019 në masën e 150 .000 lekë.

Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Tosk Energji" sha t'i paguajë paditëses Ledia Plasa pagën e pushimeve vjetore të pamarra për vitin 2019, në masën e 4 ditëve. Dhëniën e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, konform nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile.

Shpenzimet gjyqësore dhe avokatore të palës paditëse, i ngarkohen të paditurit. Ky vendim është i ekzekutuueshëm nga përmbaruesi gjyqësor.

Në total i detyroheni kreditores Ledia Llazar Plasa në shumën **6.475.814,9 lekë**.

Në kushtet kur ekzekutimi i titullit ekzekutiv, vendimi civil ekzekutimi i përkohshëm në origjinal Nr.5112, dt.02.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk është ekzekutuar vullnetarisht nga debitori duhet kaluar në ekzekutim të detyrueshëm dhe për vazhdimin tij duhet të kryhet :

-Urdhër për Heqjen e sekuestros konservative mbi Shoqërin "Tosk Energji" shpk me NIPT L51817007A me Administrator Blerim Hoxha.

-Me dt.02.02.2022 debitori bëri **shlyerjen e detyrimi monetar tërësisht ndaj kreditores**.

Sa më sipër dhe në zbatim të neneve 519,526/a,527,531,586,616/a të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit Nr.26/ 2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat."

URDHËROJMË :

1-Qëndrën Kombëtare të Biznesit Tiranë të vendosin Heqjen e sekuestros konservative mbi:

-Shoqërin "Tosk Energji" shpk me NIPT L51817007A me Administrator Blerim Hoxha.

-Me dt.02.02.2022 debitori bëri **shlyerjen e detyrimi monetar tërësisht ndaj kreditores**.

ZYRA PËRMBARIMIT PRIVAT "ALBASE" SH.P.K.
PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT
BAFTIAR NELA

